




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr. 238/2019
Datë: 12 dhjetor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.6, 1.9, 1.12, 1.17, Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 32 paragrafi 1.4 i Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 3 të Rregullores nr. 01/2014 për Procedurën e Ngritjes në Detyrë të Gjyqtarëve (e ndryshuar dhe plotësuar), në takimin e 227 –të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e z. Enver Peci, Kryetar, Gjykata Supreme e Kosovës, për shpalljen e konkursit për tri (3) pozita të lira për gjyqtarë në Gjykatë Supreme të Kosovës, prej të cilave një (1) pozitë për gjyqtar nga radhët e komuniteteve jo shumicë.
- II. Obligohet Sekretariati i KGJK-së, që të publikoj konkursin në ueb faqen e KGJK-së, si dhe të vendoset në tabelat e shpalljeve të gjykatave.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 dhjetor 2019.

A r s y e t i m

Me datë 15 tetor 2019, z. Enver Peci, Kryetar, Gjykata Supreme e Kosovës, ka parashtruar kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, për shpalljen e tri (3) pozitave për gjyqtarë në Gjykatën Supreme të Kosovës, pasi që në vitin e ardhshëm pensionohen disa gjyqtarë. Meqenëse një përqindje e madhe e rasteve që trajtohen janë me ankesa të palëve te nacionalitetit serb dhe pakicave tjera, njëra nga tri (3) pozita të lira për gjyqtarë në Gjykatë Supreme është paraparë për për gjyqtar nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

KGJK, në takimin e mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, shqyrtoi Kërkesën e Kryetarit të Gjykatës

Supreme, me ç'rast me qëllim të mbarëvajtjes së punëve dhe efikasitetit në këtë Gjykatë, aprovoi kërkesën e Kryetarit për shpalljen e tri (3) pozitave të lira për gjyqtarë.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.


Skender COCAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- *Kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës;*
- *Gjykatave të Republikës së Kosovës;*
- *Sekretariatit të KGJK-së, si dhe*
- *Arkivit.*